



PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE DHE QËNDRUESHMËRINË

In Motion
Programme



#BoostingYourBusiness

KAVAJË



 **In Motion** Kavajë u zbatua nga **PNUD** në Shqipëri si pjesë e Programit **“Rimëkëmbja Ekonomike dhe Qëndrueshmëria”**

Prill, 2023
Shqipëri

Donatorët



Kingdom of the Netherlands



British Embassy
Tirana

IN MOTION

**PËRDITËSIM I MODELIT
TË BIZNESIT**

**ASISTENCË TEKNIKE E
PERSONALIZUAR**

**ZËVENDËSIMI
I PAJISJEVE TË DËMTUARA**

**PËRMIRËSIM I IMAZHIT
TREGTAR**

PËRMBAJTJA

- 6 Historiku i projektit
- 8 Objektivat kryesore
- 10 Informacion mbi biznesin
- 14 Astrit Telaku – Restorant mëngjezore Astrit Telaku
- 16 Bledar Veizi – Veizi Tekstil
- 18 Dashamir Çelmeta – Furrë Buke Çelmeta
- 20 Erisa Qoli – Studio Qoli
- 22 Fatime Hylivu - Noalvi Parfumeri dhe Lule natyrale
- 24 Gazmir Kadiu – Bar Kafe Gazi
- 26 Lejla Degermeni – Perde Lejla
- 28 Lindita Ademi - Market
- 30 Luljeta Korriku – Bar Kafe
- 32 Lutfi Belegu – Kafe Besa
- 34 Rifat Togu – Perde Togu
- 36 Silvana Metani - Metani Market
- 38 Meleqe Kazazi - Butik Meleqe



HISTORIKU I PROJEKTIT

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) dominojnë ekonominë shqiptare, duke zënë 99.8% të numrit total të ndërmarrjeve dhe 81.6% të të gjithë punësimit. **Financuar nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe Qeveria Hollandeze**, PNUD është duke mbështetur Qeverinë Shqiptare nëpërmjet **Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike dhe Qëndrueshmërisë në Shqipëri (ERR)**. Në fokus të programit janë bizneset e prekura nga tërmeti shkatërrues i 26 nëntorit 2019, në Durrës gjithashtu edhe nga kriza e shkaktuar nga pandemia Covid-19. ERR synon të stimulojë ekonominë përmes rritjes së konkurrencës midis këtyre ndërmarrjeve. Mbështetja e rikuperimit ekonomik dhe rritjes së kapaciteteve të këtyre bizneseve konsiderohet të jetë thelbësore për rimëkëmbjen ekonomike.

“In Motion” është një **metodologji** e zbatuar më parë në Meksikë, Haiti dhe Ekuador, prej së cilës kanë përfituar më shumë se 10,000 biznese mikro dhe të vogla. Rezultatet e arritura në këto rajone shërbejnë si një tregues i fortë i impaktit të lartë pozitiv të metodologjisë, në situatat pas emergjencave natyrore, veçanërisht në drejtim të rikuperimit të jetesës dhe riaktivizimit ekonomik.



Në Shqipëri, faza e parë e **programit pilot In Motion u implementua në 15 biznese në Bashkinë e Durrësit**. Ndërhyrja filloi menjëherë pas tërmetit duke i ndihmuar këto 15 biznese të rifillonin punën e tyre me një shpresë të re.

Në nëntor të vitit 2021, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës, programi In Motion vazhdoi të zbatohet në kryeqytet duke u fokusuar në zonën e Astirit. 35 mikrobiznese të tjera të prekura nga tërmeti dhe pandemia e Covid-19 përpos mjeteve të reja dhe një imazhi tregëtar të rinovuar përfituan nga metodologjia edhe njohuri mbi përdorimin e teknologjive të reja. Kjo mund t'i ndihmojë ata në zgjerimin e biznesit dhe rritjen e aftësisë konkurruese në treg. Midis tyre përfshiheshin llojet më të zakonshme të bizneseve të vogla, si minimarket, rrobaqepsi, parukeri, berber, restorante të vogla (mezeri), dyqane etj.

Në 2022, In Motion vazhdoi të ndihmojë bizneset në Bashkinë e Kavajës. 13 NMVM u ndihmuar nga ekspertë biznesi dhe imazhi tregëtar, në mënyrë që të përmirësonin modelet e tyre ekzistuese të biznesit. Duke marrë pjesë në grupe trajnimi dhe falë asistencës së personalizuar biznese si rrobaqepsi, bar-kafe, restorante të vogëla, mini markete etj, e patën të mundur të rrisin shitjet mujore, përmirësonin strategjitë e marketingut duke tërhequr më shunë klientë në fund të zbatimit të In Motion.



CENSUS

Mbledhje e informacionit socio-ekonomik nga bizneset mikro dhe të vogla.

- Proces i digjitalizuar i cili përdor informacion gjeo-referencial.
- Lehtësim për procesimin e informacionit.



DIAGNOZA

Informacione të detajuara për situatën aktuale të biznesit dhe sipërmarrësit.

- Historiku i biznesit.
- Fusha e vlerësimit (tregu, operacionet financiare, familja, çështjet juridike)
- Veprime për përmirësimin e biznesit.



ASISTENCË TEKNIKE E PERSONALIZUAR

Ofrohet nga një konsulent i specializuar dhe i akredituar në metodologjinë "In Motion"

- Trajnime në grupe mbi financat, marketingun dhe administrimin e biznesit.
- Asistencë teknike e personalizuar pranë biznesit.



PËRMIRËSIMI I IMAZHIT TREGTAR

Biznesi përditësohet nëpërmjet:

- Zhvillimit të markës
- Pajisjeve bazë
- Reklamimit
- Infrastrukturës dhe/ose inventarit





FORCIMIT

të praktikave tregtare, kapacitetit prodhues
dhe zgjerimit të tregut



INOVACIONIT

të modelit të biznesit



PËRDITËSIMIT

të imazhit tregtar dhe pajisjeve

OBJEKTIVI KRYESOR

Objektivi kryesor i programit "In Motion", pjesë e Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (PNUD) është të përditësojë modelet e biznesit për bizneset mikro dhe të vogla që kërkojnë vëmendje gjithëpërfshirëse sipërmarrëse për të përmirësuar kapacitetin e tyre prodhues dhe marrëdhëniet e Objektivat kryesore tyre me tregun.

IN MOTION

REZULTATET



\$ 1700
për
pajisjet



\$ 300
për
imazhin
tregtar



13 biznese të
mbështetura
me asistencë
teknike të
personalizuar si
dhe përditësim
të imazhit
tregtar



12 orë
trajnime
në grup
për të
gjitha
bizneset



1 konsulent
biznesi të
angazhuar
për të
gjithë
periudhën

KAVAJË



2 ekspertë
dizajni grafik i
angazhuar për
të përmirësuar
imazhin tregtar të
bizneseve




162 orë
asistencë
teknike e
personalizuar
për të gjitha
bizneset



78 orë
asistencë e
personalizuar për
imazhin tregtar
ofruar për të
gjitha bizneset




4 muaj për
implementimin
e plotë të
metodologjisë



INFORMACION MBI BIZNESIN

VITET NË TREG



INDUSTRIA

No. %

Tregtia me pakicë (përfshin dyqanet e luleve dhe dyqanet e veshjeve)	15%
Shitja e ushqimeve të përgatitura	23%
Shitja e frutave dhe perimeve	8%
Tapiceri dhe/ose veshje	8%
Shitja dhe/ose riparimi i pajisjeve shtëpiake	15%
Shërbime interneti/fotografike	8%
Bar-kafe	23%
Totali	100%

EFEKTET E DËMTIMIT TË BIZNESEVE SI REZULTAT I TËRMETIT




INFORMACION MBI BIZNESIN

INFORMACIONE SOCIO-DEMOGRAFIKE


GJINIA



MOSHIA



EDUKIMI



"RESTORANT MËNGJEZORE"



Pronari:

ASTRIT TELAKU




Vitet në Biznes:

40 VITE



Linja e biznesit

MËNGJEZORE



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Astriti prej 40 vitesh ushtron profesionin e tij si guzhinier. Para 12 vitesh, me ruloten e tij modeste, ofronte shërbim për qytetarët në qendër të Kavajës deri sa, 4 vite më vonë, hapi mëngjezoren e tij shumë pranë qendrës. Përpos klientëve besnikë, Astriti e pati shumë të vështirë të rimëkëmbej pas tërmetit dhe pandemisë. Mungesa e imazhit tregtar dhe prezencës në rrjetet sociale e bën akoma më të vështirë biznesin të identifikohet nga turistët vendas dhe të huaj.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Angazhimi i një punëtori në rolin e kamrierit, në mënyrë që Astriti të ketë mundësi të fokusohet në kuzhinë.
- Vendosija e shërbimit “delivery” për të rritur numrin e klientelëve dhe përmirësimin e të ardhurave mujore.
- Krijimi i paketave për dreka dhe darka familjare dhe promovimi i tyre i vazhdueshëm nëpërmjet rrjeteve sociale.
- Ndarja e financave të biznesit nga ato familjare është e domosdoshme për të krijuar një sistem të qartë dhe të rregullt të administrimit dhe raportimit të të ardhurave.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative



Rritje e prezencës
Online

"RROBAQEPËSI VEIZI"



Pronari:

BLEDAR VEIZI



Vitet në Biznes:

15 VITE



Linja e biznesit:

RROBAQEPËSI



BLEDAR VEIZI
Q E M A L



PËRSHKRIM I BIZNESIT

PËRSHKRIM I SHKURTËR I Rrobaqepësi Veizi është një biznes familjar i cili ka 40 vite që operon në treg. Bledari ka 15 vite që e menaxhon biznesin duke u munduar të jetë sa më pranë kërkesave të tregut. Kohët e fundit Bledari është fokusuar në prodhimin e uniformave dhe veshjeve të punës. Dyqani është në pronësi të familjes dhe ndodhet në rrugën kryesore. Para tërmetit dhe pandemisë planet ishin për ta kthyer dyqanin në një showroom për klientët, por vështirësitë financiare të shkaktuara nga rënia e xhiros dhe mungesa e shitjeve bënë që planet e Bledarit të shtyheshin në kohë.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Prezencë aktive në rrjete sociale me postime më të detajuara mbi produktete si: video të uniformave apo veshjeve sportive dhe bluzave, për të tërhequr më shumë klientë.
- Promovimi i produkteve të personalizuara dhe me çmime të preferenciale duke patur si targetgrup moshat e reja.
- Diversifikimi i prodhimit nëpërmjet krijimit të një linje të plotë të veshjeve sportive, duke përfshirë tuta dhe bluza të stampuara, me qëllim rritjen e numrit të klientelës duke kontribuar gjithashtu në rritjen e të ardhurave në biznes.



PAS



REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajtimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative

"FURRË BUKE"



Pronari:

DASHAMIR ÇELMETA




Vitet në Biznes:

15 VITE



Linja e biznesit:

FURRË BUKE



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Dashamiri dhe Gentiana kanë jetuar për rreth 15 vite në Itali dhe më pas janë rikthyer për të hapur biznesin e tyre në Shqipëri. Ata kanë plot 12 vite që merren me prodhimin e bukës dhe prej 4 vitesh kanë marrë një ambient me qera në qendër të Kavajës. Prodhimin e bukës e kryejnë në fshatin Cetë dhe e sjellin 2 herë në ditë tek dyqani në qendër të qytetit. Para tërmetit dhe pandemisë, ata tregtonin më shumë se 400 bukë në ditë, por planet për t'u rritur dhe zhvilluar më tej mbetën të porealizuara. Mungesa e pajisjeve në dyqan si dhe mungesa e një menaxhimi të mirë të biznesit kanë sjellë vështirësi të mëdha për familjen Çelmeta që të rrisin biznesin e tyre.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Punësimi i një personi me kohë të plotë ose të pjesëshme do të lejojë Dashamirin dhe gruan e tij të rishpërndajnë detyrat dhe funksionet duke i dhënë mundësinë të përdorin më me efikasitet kohën e tyre. Kjo do të lehtësojë edhe më shumë shpërndarjen e produkteve përgjatë vijës bregdetare.
- Prania dhe promovimi i biznesit në rrjetet sociale nëpërmjet postimeve aktive të fotove dhe videove.
- Lidhja e kontratave dhe marrëveshjeve me bare dhe restorante për furnizimin me bukë është një mundësi e mirë për të ndihmuar biznesin të ketë një kërkesë të qëndrueshme, të rrisë klientelën dhe të ardhurat. er base, and boost revenues.



PAS

Shija tradicionale e bukës në tryezat tuaja!

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative

"STUDIO QOLI"




Pronari:
ERISA QOLI



Vitet në Biznes:
23 VITE



Linja e biznesit:
STUDIO FOTOGRAFIKE



Studio Qoli
— 2000 —



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Studio Qoli është një biznes familjar i hapur që në vitin 2000. Erisa dhe Suada, vajzat e familjes Qoli, sëbashku me prindërit punojnë në dyqan për të ofruar shërbimet jo vetëm për klientët por edhe për turistët vendas e të huaj të cilët vizitojnë qytetin. Ambienti ndahet në dy pjesë: pjesa e receptionit ku bëhen printimet, ekspozohen produktet si dhe ofrohet shërbimi i fotografisë, ndërsa në një ambient tjetër më të vogël, bëhet magazinimi i materialeve. Motrat Qoli janë munduar të ofrojnë shërbime inovatore për të qënë në një hap me teknologjinë dhe konkurrencën në treg, por problemet financiare të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia ia kanë vështirësuar shumë punën.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Diversifikimi i shërbimit si psh. fotografimi i eventeve të bizneseve apo bar-restoranteve të reja, të cilat kanë nevojë për material për të postuar në ëeb-site ose rrjetet sociale të tyre.
- Ofrimi i shërbimeve të reja si menaxhimi i rrjeteve sociale të bizneseve të zonës.
- Mëmbajtja shënim në mënyrë të rregullt e inventarit për të bërë planifikime për furnizim, për të patur një sistem efikas të inventarit me metodologjinë 5S dhe për të analizuar preferencat e klientëve.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative



Rritje e prezencës
Online

"NOALVI"



Pronaro:
FATIME HYLVIU



Vitet në Biznes:
11 VITE



Linja e biznesit
**NOALVI PARFUMERI
DHE LULE NATYRALE**



NOALVI



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Hylvia, sëbashku me dy vajzat, prej më shumë se 11 vitesh drejtojnë biznesin familjar në të cilin ofrojnë lule natyrale si dhe parfume apo produkte kozmetike për klientët e tyre. Parfimet me mbushje përgatiten nga vetë vajza, Suada, e cila është e specializuar në këtë fushë. Pas pandemisë klientela u tkurr shumë pasi edhe shërbimet që dyqani ofronte si zburime për festa apo për makinat e nuseve, nuk funksiononin më. Vështirësitë ekonomike me të cilat u përball biznesi ia vështirësuan punën Hylvies për t'u rritur dhe për ta bërë Noalvin një biznes konkurruese në treg.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Riformatimi i strukturës menaxhuese duke vënë në krye të biznesit vajzat dhe duke hequr nga vetja barrën financiare të pagesës së siguracioneve për zonjën Fatime e cila ka dalë në pension.
- Punësimi i një personi të kualifikuar për përzjerjen e parfumeve dhe përgatitjen e dekorimeve të luleve duke bërë punën më frytdhënëse dhe më të menaxhueshme.
- Promovimi i vazhdueshëm i produkteve nëpërmjet ofertave sipas periudhave festive dhe përdorimi aktiv i rrjeteve sociale.
- Mbajtja dhe kontrolli i rregullt i të ardhurave është e rëndësishme për të pasur një pamje të qartë të ecurisë së biznesit.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit




Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative

"BAR KAFE GAZI"




Pronari:
GAZMIR KADIU



Vitet në Biznes:
15 VITE



Linja e biznesit
BAR KAFE



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Gazmiri ka rreth 15 vite që ofron shërbimin bar-kafe në qëndër të qytetit të Kavajës. Ambienti është në pronësinë e tij dhe nuk ka punonjës të tjerë që ta ndihmojnë. Gazmiri ka mbaruar shkollën teknologjike dhe njohuritë e tij në menaxhimin e biznesit janë të limituara vetëm në atë çfarë i ka mësuar eksperiencën gjatë këtyre viteve. Megjithatë përballja me tërmetin dhe pandeminë e gjetën Gazirin të papërgatitur duke i shkaktuar humbje të mëdha financiare dhe vështirësi për t'u zhvilluar më tej.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Shtimi i personelit është tepër i rëndësishëm për realizimin më efektiv dhe cilësor të shërbimit ndaj klientëve dhe mbajtjes pastër dhe rregull biznesin
- Krijimi i një filozofie, si psh. Bar-kafe sporti, për të dalluar Kafe Gazin nga kafetë e tjera dhe përshtatja e saj me ambientin fizik do të tërheqë më shumë klientë.
- Promovimi aktiv në rrjete sociale dhe duke mbajtur të informuar klientët me produktet dhe shërbimet e ofruara.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative

"PERDE LEJLA"



Pronari:
LEJLA DEGËRMENI



Vitet në Biznes:
40 VITE



Linja e biznesit
RROBAQEPËSI



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Lejla ushtron profesionin e rrobaqepëses prej rreth 40 vitesh. Fillesat e saj i ka patur në Qëndistarinë e Kavajës dhe prej 2006 ajo ka hapur biznesin e saj privat. Në dyqanin modest, Lejla ofron shërbime të ndryshme si për shtëpi ashtu dhe për hoteleri. Në përditshmëri ajo ndihmohet dhe nga bashkëshorti, kryesisht përsa i përket montimit të perdeve apo menaxhimit të furnizimeve. Pavarësisht dëshirës së madhe për t'u zgjeruar dhe për të punësuar ndihmës të tjerë, mungesa e burimeve financiare pas tërmetit dhe pandemisë Covid-19, ia kanë vështirësuar punën tejmase.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Lidhja e marrëveshjeve me kompani online për reklamimin dhe shitjen e produkteve artizanale me qëllim rritjen e të ardhurave mujore.
- Lidhja e një marrëveshjeje me një postë për të ulur kostot e transportit të shpërndarjes së produkteve për klientët online.
- Postimi në mënyrë më aktive i fotove, videove dhe veçanërisht i "reels" për të reklamuar produktet dhe shërbi- met e reja që ofron në treg.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative



Rritje e prezencës
Online

" MARKET "




Pronari
LINDITA ADEMI



Vitet në Biznes:
23 VITE



Linja e biznesit
MINI MARKET



 **arket**



PARA

PËRSHKRIM I BIZNESIT

Lindita ka rreth 23 vite qe menaxhon marketin. Është një biznes familjar i cili iu shërben kryesisht familjeve që ndodhen afër si dhe fëmijëve që ndjekin shkollën e cila ndodhet shumë pranë marketit. Ky është ndër të vetmit biznes në zonë i cili rri i hapur deri në orët e vona të natës. Ambienti është relativisht i vogël dhe pavarësisht përpjekjeve disa vjeçare për t'u rritur dhe zhvilluar më tej, tërmeti dhe pandemia Covid-19 ia kanë vështirësuar tejmasë punën.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Ri-organizimi i ambientit me filozofinë 5S, deri sa të arrihet një ambjent më i aksesueshëm për klientet dhe më i menaxhueshëm për Silvanën
- Kategorizimi i plotë i produkteve është i rëndësishëm për një shërbim më cilësor dhe do të sigurojë më shumë lehtësi në përzgjedhjen e produkteve nga klientët.
- Promovimi i produkteve të reja apo në ofertë nëpërmjet rrjeteve sociale mund të tërheqë vëmendjen e më shumë klientëve.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative

"BAR KAFE"



Pronari

LULJETA KORRIKU




Vitet në Biznes:

18 VITE



Linja e biznesit

BAR KAFE



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Prej rreth 18 vitesh, Luljeta dhe i shoqi ofrojnë shërbimet në bar-kafen e tyre e cila ndodhet në rrugën kryesore të qytetit. Me një klientelë besnike dhe turista të shumtë ata janë munduar të zgjerojnë gamën e produkteve të ofruara, por pandemia ia u vështirësoi shumë punën duke mos i lënë hapësirë për t'u zhvilluar.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Krijimi i paketave promovionale për të tërhequr më shumë klientë, vënaërisht për të tërhequr klientë të grupmohave të reja dhe familjarët.
- Përshtatja e ambienteve të brendshme për të pritur një numër më të madh klientësh gjatë dimrit.
- Mbatja ditore e informacionit financiar, duke përdorur formatin e të ardhurave dhe shpenzimeve, për të mundësuar një analizë më të qartë lidhur me ecurinë e biznesit.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative



Rritje e prezencës
Online

"KAFÉ BESA"



Pronari

LUTFI BELEGU



Vitet në Biznes:

15 VITE




Linja e biznesit

BAR KAFE



Kafé Besa



PARA

PËRSHKRIM I BIZNESIT

Kafe Besa, që nderon emrin e ekipit të futbollit të Kavajës, prej më shumë se 15 vitesh ofron shërbim për qytetarët dhe turistët në qendër të Kavajës. Lutfi, i cili ka më shumë se 40 vite eksperiencë në këtë fushë, ka kaluar vështirësi të ndryshme gjatë gjithë këtyre viteve në treg, por tërmeti ishte ai që i solli dëme jo vetëm fizike, por edhe financiare. Sëbashku me bashkëshorten janë munduar të ofrojnë një shërbim sa më të mirë për klientët, por vështirësitë financiare i kanë penguar të zgjerohen më tej dhe të sistemojnë ambientin në të cilin ndodhen.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Krijimi dhe ofrimi i paketave promovionale për të rritur numrin e klientëve.
- Promovimi i biznesit dhe i produkteve të ofruara nëpërmjet rrjeteve sociale sipas një kalendari të mirëpërcaktuar.
- Mbajtja e inventarit dhe kontrolli i tij i vazhdueshëm në bazë të nevojave të biznesit.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajtimeve dhe Këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative




Rritje e prezencës
Online

"PERDE TOGU"



Pronari
RIFAT TOGU



Vitet në Biznes:
21 VITE



Linja e biznesit
RROBAQËPËSI



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Rifati ka që në vitin 2002 që sëbashku me familjen e tij janë angazhuar në biznes. Ai ofron prodhim dhe montim të perdeve për familjet dhe bizneset e ndryshme. Ndonjëherë Rifati ndihmohet edhe nga punëtorë të tjerë me kohë të pjesshme, por vështirësië financiare që erdhën si pasojë e tërmetit dhe pandemisë Covid-19 nuk i dhanë mundësinë të zgjeronte më shumë biznesin dhe të punësonte punonjës të tjerë me kohë të plotë për të përmbushur kërkesat e klientëve jashtë zonës së Kavajës.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Vendosja e tabelave me përmbajtje promocionale në vende më të dukshme në hyrje të dyqanit me qëllim tërheqjen e klientëve.
- Promovimi aktiv në rrjete sociale i produkteve në ofertë gjatë periudhave festive apo kulmit të sezonit.
- Vjimi i kontrollit financiar për të pasur gjithmonë një fotografi të qartë të ecurisë së biznesit.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative



Rritje e prezencës
Online

"METANI MARKET"



Pronari
SILVANA METANI



Vitet në Biznes:
20 VITE



LINJA E BIZNESIT
MINI MARKET



PARA

PËRSHKRIM I BIZNESIT

Silvana ka qënë e para e cila hapi biznesin e saj 20 vite më parë në lagjen ku ndodhet edhe sot. Në marketin e saj modest ajo ofron produkte të ndryshme ushqimore. Pëpros problemeve të shkaktuara nga rritja e konkurrencës në treg, tërmeti dhe pandemia shkaktuan probleme akoma më të mëdha financiare duke mos i dhënë asnjë hapësirë për t'u rritur dhe përballuar kërkesën e tregut.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Riorganizimi i ambientit me filozofinë 5S, deri sa të arrihet një ambjent më i aksesueshëm për klientet dhe më i menaxhueshëm për Silvanën.
- Mbajtja e një inventari dhe reklamimi produkteve në ofertë me anë të tabelave apo postimeve aktive në rrjetet sociale.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajnimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative



Rritje e prezencës
Online

"BUTIK MELEQE"



Pronari

MELEQE KAZAZI




Vitet në Biznes:

25 VITE



Linja e biznesit

BUTIK



Butik Meleqe

— 1999 —



PËRSHKRIM I BIZNESIT

Butik Meleqe ofron produkte për klientët e saj që në vitin 1999. Asnjëherë e braktisur nga klientela besnike e krijuar gjatë 25 viteve, Melqe sërisht u përball me vështirësi financiare që erdhën si pasojë e mbylljes së biznesit gjatë periudhës së tërmetit dhe pandemisë Covid-19. Tërmeti gjithashtu shkaktoi dëmtime në strukturë të cilat ishin të dukshme. Aktive në rrjetet sociale, por ajo që i mungon është një ambient i mirëpajisur për të ofruar shërbime sa më cilësore për klientët e saj.

PLANET E PËRMIRËSIMIT

- Krijimi i një hapësire me kushtet e nevojshme për të qënë një showroom.
- Sistemim më i përshtatshëm i ambjentit të punës dhe krijimi i një inventari për të kontrolluar më mirë shitjet.
- Promovimi i vazhdueshëm i produkteve në rrjetet sociale nëpërmjet ofertave sipas periudhave të ndryshme të vitit.
- Vijimi i kontrollit financiar për të pasur gjithmonë një fotografi të qartë të ecurisë së biznesit.



PAS

REZULTATET



Pajisje të reja
për Biznesin



Rritje e produktivitetit të Biznesit
nëpërmjet Trajtimeve dhe këshillimit



Krijimin e imazhit të biznesit si dhe
Materiale promovuese inovative

PROGRAMI PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE DHE QËNDRUESHMËRINË

In Motion
Programme



#BoostingYourBusiness